



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 08.02.2019, ora 12.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i projekt Rregullores së Brendshme, për organizimin dhe funksionimin e KED-së.

Marrin pjesë :

1. Ardian Dvorani	Kryetar
2. Vitore Tusha	Zëvendës kryetare
3. Arta Marku	Anëtare
4. Fatri Islamaj	Anëtar
5. Margarita Buhali	Anëtare
6. Fatjona Memçaj	Anëtare
7. Eriol Roshi	Anëtar
8. Medi Bici	Anëtar zëvendësues
9. Gurali Brahimllari	Anëtar zëvendësues
10. Klodiana Veizi (Mema)	Anëtare zëvendësuese

¹Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.
3. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.
4. Enkelejd Alibeaj, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Anita Mihailova, eksperte e EURALIUS
2. Klodian Rado, ekspert i EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. Vijimi i diskutimit dhe miratimi i Projektregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.

Këshilli fillon diskutimin lidhur me dispozitat e Projektregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Diskutimi vijon aty ku ishte ndërprerë në mbledhjen e kaluar, duke filluar nga neni 13 i projektregullores.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e nenit 13 “Drejtimi i mbledhjeve të Këshillit”.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për përmbajtjen e nenit 14 “Pjesëmarrësit në mbledhjet e Këshillit”, e riformuluar në reflektim të diskutimeve të mbledhjes së datës 01.02.2019.

Në lidhje me pikën 4 të këtij neni, për mundësinë e pjesëmarrjes së institucioneve që ligji i ngarkon me kompetenca për monitorimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të reja të drejtësisë, përkatësisht edhe të Komisionit që ka ngritur Kuvendi për këtë qëllim, *pas diskutimit të anëtarëve të Këshillit*, shprehin mendimet e tyre Avokati i Popullit dhe përfaqësues të subjekteve të ftuar sipas ligjit.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se nuk ka ndonjë kundërshtim, d.m.th për këtë çështje mund të vendosë si të gjykojë Këshilli. Por, duke dhënë eksperiencën personale, ku në bazë të Kushtetutës monitoroj çdo organ shtetëror përveç sistemit gjyqësor. Në qoftë se ka një pikëpyetje, një problematikë kërkojmë dhe më jepet informacion ose mund të kërkoj të jem pjesëmarrës në një rast të caktuar e kjo nuk më ndalohej, por jo që të kemi nga institucioni ndonjë ftesë aktive. Nëse ata do të kërkojnë që të marrim pjesë, kjo do të vlerësohet rast pas rasti nga Komisioni ose sigurisht do të jepet informacioni i duhur që ata kërkojnë në rrugë shkresore. Kështu funksionon institucioni jonë deri më tani që e ka këtë kompetencë për të gjithë organet e administratës shtetërore, gjithmonë monitorimit për të drejtat e njeriut.

Genci Gjonçaj kërkon fjalën dhe parashtron se ngritja e këtij Komisioni është parashikuar në dispozitën e nenit 288. Ky Komision është ngritur në mënyrë të posaçme nga Kuvendi me një objekt të caktuar. Në çdo institucion që i ngarkohet për të monitoruar proceset, ata kanë marrë pjesë. Ky Komision mund të mos ftohet në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për shkak të specifikës që ka parashikuar vetë ligji. Por mendoj që për çështjet ku diskutohet veçanërisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë padyshim që ky Komision do të duhet të ftohet sepse është ndër çështjet që e kanë në kompetencë për ta monitoruar. Padyshim këtu ka përfaqësues të Kryetarit të Kuvendit, të Komisionit të Ligjeve, sipas përkatësisë maxhorancë-opozitë, por kjo nuk plotëson nevojën për të pasur prezent dhe për të monitoruar këtë Këshill aq më tepër që është një Këshill i Përkohshëm. Për çështjet e tjera që dalin jashtë tagrit monitorues të këtij Komisioni dakord që të mos ftohen. Por sa i takon mbledhjeve ku diskutohen çështje që janë brenda kompetencës së këtij Komisioni, duhet të ftohet jo vetëm për faktin që çfarë monitoron e ka objekt pune, por dhe për faktin e transparencës në raport me një Komision që është krijuar me vendim të posaçëm të Kuvendit.

Enkelejd Alibeaj kërkon fjalën dhe parashtron se lidhur me këtë çështje si gjithmonë vendimmarja është e juaja që të saktësoni masën e publikimit të veprimtarisë tuaj sepse ajo

mediatike është e përcaktuar në ligj. Por dy çështje duhet të mbani parasysh para se ta vlerësoni.

E para, ligji 115/2016 parashikon në nenin 288 të tij ngritjen e një Komisioni të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit këtij ligji. Si përfaqësues i Kuvendit në këtë rast do të duhet të sjell para jush fakte për të cilat ju mund të keni qenë fare indiferent por që për këtë vendimmarje kam përshtypjen se janë të rëndësishme. E para, ky Komision do duhej të ishte i ngritur i pari pas miratimit të ligjit nga Kuvendi, i cili do të monitoronte më pas dorë pas dore ngritjen e çdo institucioni tjetër të ri të reformës në drejtësi. Fakt që s'ka ndodhur. Dhe është faji totalisht i Kuvendit, përfshij edhe veten kur flas si përfaqësues i Kuvendit. Kjo do të thotë nuk e ka parë të nevojshme Kuvendi në atë kohë, madje jo vetëm në atë kohë por për shumë kohë që ta ngrinte. Kjo tregon shumë mbi ndjeshmërinë që Kuvendi kishte derisa u ngrit ky Komision për ngritjen e institucioneve të reja, e para.

E dyta, emërtohet si Komision i Pavarur por nuk është i tillë. Të gjithë anëtarët në këtë Komision janë zgjedhur vetëm prej maxhorancës, me shumicë të thjeshtë. Dhe kushdo e kupton që me shumicë të thjeshtë elementi thelbësor i pavarësisë nuk ekziston as në zgjedhje dhe as në llogaridhënie. Në analizë të fundit ky Komision nuk i shërben Kuvendit dhe as veprimtaria e tij nuk është e pavarur, neutrale, por i shërben maxhorancës, asaj që e ka zgjedhur.

Së treti, vetëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, legjislatori ka përdorur mekanizma të drejtpërdrejtë të pjesëmarrjes, të vëzhgimit dhe duke e lidhur këtë me logjikën që përdor neni 288, ky Komision i Pavarur veprimtarinë e tij do ta raportojë tek Komisioni i Ligjeve, i cili ka dy përfaqësues në këtë Këshill, tre përfaqësues bashkë me përfaqësuesin e Kryetarit të Kuvendit. Nuk jam duke thënë të marrin pjesë apo jo por jam duke parashtruar tre konsiderata të cilat duhen marrë parasysh në përcaktimin e pjesëmarrjes së këtij Komisioni.

Ulsi Manja kërkon fjalën dhe parashtron se është vonë apo herët, do të duhet ta kishte ngritur me kohë apo jo Kuvendi kjo është një diskutim *postfactum* dhe nuk besoj se i përket kësaj tryeze. Me votat e shumicës apo me konsensus ligjvënësi ka votuar në zbatim të ligjit këtë Komision që në fakt është një komision koordinimi e monitorimi që ndjek pikërisht zbatimin e ligjit nr. 115 të vitit 2016. Jo më kot ligjvënësi e ka vendosur në dispozitat tranzitore në fakt sepse monitoron proceset e përzgjedhjes së kandidatëve dhe të emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë. Dhe ky Këshill ka në kompetencë anëtarët për në Gjykatë Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Nuk do të ishte

logjike të ishin prezent këtu në mbledhje kur të përzgjidhen anëtarët e Gjykatës Kushtetuese sepse del jashtë objektit të nenit 288. Por për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë edhe pse jemi këtu përfaqësuesit e Kuvendit dhe të Komisionit të Ligjeve, në fakt Kuvendi dhe ligjvënësi këtë ka pasur parasysh që ky Komision të jetë një mekanizëm i ndërmjetëm mes legjislativit dhe organeve të reja të qeverisjes të sistemit të drejtësisë. Është çështje e juaja e ftoni apo se ftoni, por besoj që transparencës do t'i bënte mirë që të kishte një sy edhe Kuvendi i Shqipërisë dhe këtu kam parasysh legjislativin në tërësi dhe ta kishte në momentin e përzgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Jam dakord me sugjerimin që bëni ju, që duhet të jetë vetëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nëse merrni vendim që ata të ftohen, të ndjekin vetëm zbatimin e ligjit dhe nuk ka arsye që t'iu jepet edhe e drejta e fjalës. Gjithsesi është çështje e juaja nëse do ta pranoni ose jo, nuk kam ndonjë sugjerim konkret.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, vendosin të hiqet pika 4 dhe të miratohet me ndryshime përmbajtja e nenit 14 “Pjesëmarrësit në mbledhjet e Këshillit”.

Anëtarët e Këshillit vijojnë diskutimin për përmbajtjen e nenit 15 “Procedura në rast papajtueshmërie dhe konflikti të interesit”, e riformuluar mbi propozimet me shkrim të pjesëmarrësve dhe të diskutimeve të mbledhjes së datës 01.02.2019, veçanërisht për problematikën e mënyrës së procedimit në rastet kur për shkak të papajtueshmërisë ose konfliktit të interesit të anëtarëve të Këshillit, Avokatit të Popullit ose përfaqësuesve të subjekteve të ftuar sipas ligjit, krijohen rrethana që nuk lejojnë vijimin e funksionalitetit të Këshillit.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se kjo është një prej çështjeve që ka më shumë diskutim dhe duhet të vendosim në balancë, së pari mbi mundësinë e kryerjes efektive të detyrës dhe në këtë kuadër jam dakord me rëndësinë që i jepet funksionalitetit të organit. Por nga ana tjetër, mënyra si do ta kryejmë detyrën duhet të jetë e tillë që të mos krijojë tek publiku as edhe një lloj dyshimi se jemi mbledhur dhe po caktojmë veten, po zgjedhim njerëz të cilët janë të paracaktuar dhe po veprojmë në konflikt interesi. Kjo për efekt të krijimit të asaj balance e cila do të jetë e nevojshme që përtej çdo dyshimi të mbesë besimi i publikut se ky organ ka kryer një punë të mirë dhe në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor. Kështu që në këto kushte, në mënyrën sesi po diskutojmë, secili po diskuton për shkak të eksperiencës së të qenit gjyqtar dhe po e konsideron duke sjellë raste të gjykimeve. Ndoshta do të ishte rasti të konsideronit Këshillin siç është, një organ administrativ që është duke kryer një funksion administrativ. Për këtë arsye të shikoni zgjidhjet që jep për vendimmarrjen administrative ligji për konfliktin e interesave dhe për shmangien e tyre. Propozimi që ne si

institucion kishim bërë, ndonëse pa e zgjidhur tërësisht problematikën është se dy janë mundësitë. E para duhet t'i drejtohem dhe njëherë Kuvendit kur gjendemi në këtë rast e Kuvendi të hedhë edhe njëherë short për një anëtar. Kush është gjëja më e rëndësishme moskryerja e shortit në dhjetor apo funksionimi i organit? Besojmë që sigurisht është funksionimi i organit. E dyta të kishte një vendimmarrje e cila të dilte nga ky Këshill dhe propozojmë që t'i dërgohej ILDKPI-së për interpretim rasti konkret, në mënyrë që, në të ardhmen, kandidatët të kenë të drejtën të ankimojnë vendimet tona. Pra, të paktën të kishte një *double check* apo një *check and balance* që nuk do të ishte drejtpërdrejt i organit tonë, e të mos thonë vetë u mblodhët vetë vendosët.

Mund të ketë edhe raste zoti Kryetar, siç edhe ju në fakt e bëtë kur dhatë dorëheqjen nga kandidimi. Nëse s'do të ishte kjo dispozitë mund të ndodhte që ju megjithëse do të kandidonit edhe vetë, do duhet të votonit edhe vetë. Kjo do të ishte pozita më e keqe e mundshme të cilën nuk do ta pranonin edhe vetë anëtarët. Me të drejtë juve p.sh. hoqët dorë nga kandidimi sepse kuptuat që kjo situatë mund të jetë një situatë eventuale që do ta ulte edhe figurën e tij tek publiku. Këto janë mendime dhe, ne nuk kemi një qëndrim sepse është shumë i rëndësishëm si funksionaliteti ashtu edhe besimi i publikut, por edhe krijon mundësi që kandidatët mund ta çojnë procesin në *kalendat greke* duke bërë ankime pa fund dhe duke pasur edhe shkak se këto për shembull janë shkaqe jo të vogla të pavlefshmërisë. Nuk është menduar kur është bërë Kushtetuta dhe zgjidhja më e drejtë do të ishte të hidhej përsëri shorti kur nuk do të ketë pesë anëtarë.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se nga ajo që sugjeroi apo komentoi Avokatja e Popullit kujtohet që përpara një viti është trajtuar shkresërisht çështja e kuorunit dhe humbja e kuorunit të KED-së. Kemi pasur një komunikim me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit drejtuar Presidentit për tu rihedhur shorti, gjatë periudhës qershor-korrik 2018, kërkesë që u paraqit edhe pse kuorumi i KED në atë moment ekzistonte, sepse kuorumi në vlerësimin e Institucionit të Presidentit, d.m.th numri 5 (pesë) i anëtarëve të KED-së së kaluar humbi në 14 tetor 2018. Në atë material shkresor të Presidentit të Republikës është trajtuar në mënyrë shteruese i gjithë ky moment, gjithë ky ngërç që po vinte nga procesi i shkarkimit të disa anëtarëve. Në vlerësimin e Presidentit të Republikës nuk kishim dispozita që të rihidhnim sërish një short për të plotësuar vakancat që po krijoheshin brenda KED-së dhe i kemi kërkuar Kuvendit që të investohej nëpërmjet procesit legjislativ për plotësimin e dispozitave ligjore për ta mundësuar atë. Për koha kaloi dhe ndodhi (tetor 2018) që KED-ja humbi kuorumin total dhe erdhëm tek zgjedhja e KED-së së re 2019. Mbështesim qëndrimin

e Avokates së Popullit që një proces përzgjedhës jo vetëm duhet të jetë i drejtë por dhe duhet të duket i drejtë, sepse konflikti i interesit nuk është vetëm veprim dhe vendimmarrje. Ky është qëndrimi im personal. Është edhe qenia prezent. Pra p.sh., sikur kandidatura ime si i ftuar të shqyrtohej nga ju prapë unë nuk do ndihesha rehat, edhe ju po ashtu, në qoftë se unë do të isha prezent. Kështu që, balanca në vendimmarrjen tuaj për formulimin e këtyre dispozitave duhet të jetë shumë e kujdesshme.

Enkelejd Alibeaj kërkon fjalën dhe parashtron se Këshilli nuk po bën ligje të reja por duhet thjesht të miratojë disa rregulla të brendshme që nuk kanë efekte jashtë këtij organi. Lënda që diskutohet në fakt ka qenë thelbi edhe i ndryshimit kushtetues lidhur me krijimin dhe organizimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Premisa bazë, nga e cila është nisur profilizimi i këtij organi ishte se emërimet bëheshin në konflikt interesi politik e personal. *Së dyti*, po diskutohet një lëndë e cila ka ndoshta mbulimin më të madh ligjor dhe nënligjor. Ligji nr.115/2016 ka dispozita për konfliktin e interesit, rastet dhe mënyrën e zgjidhjes. Kodi i Procedurës Administrative ka dispozita të cilat targetojnë saktësisht konfliktin e interesit. Ligji për funksionimin e organeve kolegjiale ka dhe ai dispozita për konfliktin e interesit. Ka dhe një ligj të posaçëm të miratuar për konfliktin e interesit, i cili i mbulon jo vetëm çështjet e materies, rastet kur, por edhe çështjet e procedurës si duhet të zgjidhet. Ka dhe një organizëm të ngritur posaçërisht për këtë qëllim. *Së treti*, çështja e konfliktit të interesit është çështje individuale e secilit prej anëtarëve të Këshillit që nuk vendoset në mënyrë kolegjiale. Nëse anëtari i Këshillit e konstaton dhe deklaron nuk do të marrë pjesë, Këshilli nuk mund të vendosë ta detyrojë të marrë pjesë. Është detyrim në bazë të ligjit për konfliktin e interesit që çdo fillim mbledhje për lëndën përkatëse të vetëdeklaroni faktin nëse keni apo jo konflikt interesi.

Në dispozitën që diskutohet në thelb parashikohet që edhe nëse jam në konflikt interesi anëtari do të marr pjesë në mbledhjen e Këshillit për shkak të garantimit të parimit të funksionalitetit të tij. Këtë detyrim nuk e ka dhënë askush përveç detyrimit që të zbatohet ligji. Është thjesht dhe vetëm një ofertë për pazar. Nëse njërit mund t'i tolerohet si justifikim për shkak të funksionalitetit duke qenë në konflikt interesi të marrë pjesë dhe të votojë, këtë mund ta bëjnë të gjithë. Duke i shtuar kësaj edhe presionin që do të ketë sepse do të bëhet përzgjedhja e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërkohë që Këshilli do të jetë në monitorim intensiv nga shumë forca politike, publike dhe neutrale. Kuadri legjislativ është i plotë dhe i qartë dhe është përgjegjësi e gjithsecilit. Mund të ndodhë rasti fatkeq që numri të bjerë nën kuorum. Por, së pari, kjo mospjesëmarrja e anëtarëve rrezaton respekt të Kushtetutës dhe të ligjit dhe kurajo për ta deklaruar konfliktin e

interesit. Pas kësaj problemi nuk është më i juaji dhe Këshilli nuk duhet të ngarkohet me një peshë që nuk e ka. Zgjedhjet janë parlamentare, publike, politike.

Rregullat që propozohen në projekt nuk e eklipsojnë dot ligjin për konfliktin e interesit dhe masat që jep ai për zgjidhje mbi aktin të cilin e sanksionon me pavlefshmëri dhe mbi përgjegjësinë disiplinore të individit. Prandaj zgjidhja e konfliktit të interesit në këtë Këshill duhet të jetë rast për rast dhe nuk ka nevojë për rregulla shtesë. E vetmja gjë që mund të bëjë Këshilli është të parashikohet që për konfliktin e interesit do të zbatohen Kodi i Procedurës Administrative, ligji për konfliktin e interesit dhe ligji për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

Konflikti i interesit në thelbin e vet ka të bëjë me vendimmarrje, por është po kaq i rëndësishëm, madje shumë herë më tepër i rëndësishëm është dukja dhe imazhi në publik që ky Këshill të rrezatojë sinjale neutraliteti, profesionalizmi dhe jo klientelizmi politik. Kjo do të thotë që jo vetëm për anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por edhe në të tjerët, përjashto Avokaten e Popullit, do të duhet të vendoset i njëjti detyrim, pavarësisht aftësisë, kapacitetit, të drejtës për të votuar apo jo sepse influencë është, e tillë është edhe fjala. Në të politikës kemi edhe një tjetër mekanizëm që nuk e kanë anëtarët e Këshillit. Meqenëse jemi publikisht të ekspozuar e kemi këtë lloj risku, e shkruajnë apo nuk e shkruajnë në rregullore. Për Avokatin e Popullit çështja është ndryshe. Duke qenë se është në rolin e vëzhguesit kurrsesi nuk duhet të ketë një ndalim të tillë sepse mund të përdoret si mekanizëm për ta anashkaluar.

Avokati duke qenë se është i Popullit presupozohet që është nga ana e popullit, për definicion, për këtë arsye nuk mund të bjerë dot në konflikt interesi. Në rast të tillë do të sjellë në mbledhje një komisioner.

Ulsi Manja kërkon fjalën dhe parashtron se ky problem zgjedhjen e ka duke zbatuar ligjin dhe kështu nuk ka nevojë të të mbrojtë askush, as legjislativi dhe as ekzekutivi. Një gjë është i qartë se nga neni 222 deri në nenin 225, ligji ka përcaktuar rastet e konfliktit të interesit por ka përcaktuar dhe mekanizmin e shmangies së konfliktit të interesit. Rastet e konfliktit të interesit trajtohen rast pas rasti. Në rast se do të kemi konflikt interesi në finale ka një organ tjetër që e deklaron, siç ka dhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me zbatimin e ligjeve të reformës në drejtësi ku parashikohet që në çdo rast ato duhen interpretuar në drejtim të zhblllokimit të reformës në sistemin e drejtësisë. Por gjithsesi ky është një diskutim duhet të bëhet në kohën e duhur dhe në momentin e duhur kur thirren rastet e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të nenit 222 deri në nenin 225 të ligjit. Sugjerimi është që pika 4 e nenit 15 të projektregullores është e tepërt. Është e mjaftueshme

pika 3 dhe s'ka nevojë për tu ndalur të diskutojmë sot se çfarë do të ndodhë nesër ose pasnesër.

Jemi dakord që pika 6 duhet edhe për ne të ftuarit që marrim pjesë në mbledhje. Pra jo vetëm shmangim konfliktin e interesit, për ata që kanë të drejtë vote por dhe në dukje prezenca jonë këtu do të duhet të jetë neutrale. Mund të kemi konflikt interesi këtu në mbledhje pavarësisht se nuk kemi të drejtë vote kur diskutohet një kandidaturë që e kemi lidhje të afërt. Patjetër kjo mund të ndikojë mbi anëtarët e Këshillit, mendime shprehim edhe ne këtu. Ndërsa për Avokatin e Popullit, mendojmë që pika 6 duhet të mbetet siç është sepse këtu nuk po flasim për Avokatin e Popullit në kuptimin e zonjës shumë të nderuar që kemi këtu në tavolinë, por po flasim për institucionin. Aq më tepër që në një nen pak më përpara, u votua që kur Avokatja e Popullit nuk do të jetë vetë e pranishme do të sjellë një Komisioner.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtro se jam shumë dakord që përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, rast pas rasti, do të duhet ta deklarojë konfliktin e interesit. Por institucioni nuk ka si të jetë në konflikt interesi. Në rolin individual unë si individ mund të kem një të afërm apo ku di unë një njeri që është në kushtet e konfliktit të interesit sipas ligjit, por jo institucioni dhe sigurisht se institucioni përfaqësohet rast pas rasti prej meje ose nga një prej Komisionerëve në këtë Këshill. Pra mund të thuhet që Avokati i Popullit të marrë masat që personi që përfaqëson atë të mos ketë konflikt interesi.

Ardian Dvorani, duke përmbledhur diskutimet parashtro se neni 15 miratohet me riformulime, si edhe duke hequr pikat 4 dhe 5 të tij.

Ardian Dvorani, pas këshillimit me pjesëmarrësit cakton 15 minuta pushim.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Ardian Dvorani, orienton vijimin e diskutimit të dispozitave të projektregullores me nenin 16 “Kuorumi i mbledhjes së Këshillit”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje .

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 16 të projektregullores, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Ardian Dvorani, orienton vijimin e diskutimit të dispozitave të projektregullores me nenin 17 “Punimet e mbledhjes së Këshillit”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje .

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për përmbajtjen e nenit 17.

Erinda Ballanca, lidhur me diskutimet për pikën 14 (që bëhet pika 13), kërkon fjalën dhe parashtro se, së pari, referencat e ligjit për organet kolegjiale duhen bërë. Por, lidhur me çështjen tjetër, mbi mundësinë e kryetarit për të pasur dy vota, nëse do ketë barazim, atëherë

kryetari pa diskutim nuk duhet të shprehë votën e fundit, sepse nuk është e thënë që vendimmarrja të jetë gjithmonë e qartë. Ka dhe raste në të cilat anëtari ka edhe pikëpyetje, diskutime, është i dyzuar, ndaj edhe duhet ta kishte parasysh edhe këtë gjë në vendimmarrjen e vet. Megjithatë do ishte e këshillueshme që çështjet të diskutohen paraprakisht, para se të kalohet në votim, d.m.th mundet secili prej anëtarëve ta ridiskutojë edhe njëherë çështjen, përpara se të jepej një e drejte për të pasur një vote dyfishe njërit prej anëtarëve. Ndërsa një problem tjetër që mund të lindë, është nëse një kandidaturë do të çojë përpara procesin. Kryesore për KED nuk është skualifikimi, por kualifikimi. Prandaj duhet interpretuar në këtë logjikë, që askush që nuk ka marrë shumicën nuk mund të shkojë përpara dhe jo e kundërta. Procesi është përzgjedhja dhe renditja e tërë kandidatëve. Nuk mund të themi që një person që nuk e kemi skualifikuar mund të vazhdojë sepse nuk kemi vota për ta skualifikuar.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtron se nuk do ta shikoj vetëm këtë dispozitë në rregullore në një dispozitë të veçuar të ligjit nr.115/2016. Si jurist nuk e shikoj dot kështu. Sepse logjika e funksionimit të KED, siç është ndërtuar dhe parashikuar të funksionojë, është ndërtuar me numra precizë, 9 anëtarë dhe anëtare zëvendësues prezent për të zëvendësuar këdo që nuk është në mbledhje. Edhe numri është i saktë 5 (pesë) me shumicë. Kryetarin nuk e zgjedhën anëtarët që ti japim një vlerë përmbi tyre, atë e zgjedhi ligji. Kryetari është anëtari i Gjykatës së Lartë. Po ashtu edhe zëvendëskryetarin e zgjedhi sërish ligji dhe, në këtë logjike, unë mbështes më shumë idenë e zonjës Tusha. Në logjikën kushtetuese për atë që është mundur mund të shkojmë tek një ligj tjetër, i cili duhet thënë se është një akt ligjor që daton në kohë dhe shumë vite më parë. Ndërsa mënyra se si votohet mendoj se është më e qartë në ligjin ekzistues, me shumicë, referuar gjithë frymës së ligjit ose gjithë kapitullit të ligjit nr.115/2016, që flet për KED, jo ndonjë dispozite të veçantë.

Genci Gjonçaj kërkon fjalën dhe parashtron se është rëndësishme që procesi mos të ndalojë për një arsye ose një tjetër. Mund të ketë disa tipologji vendimmarrjesh përpara jush. Është e rëndësishme dhe është mire që diskutohet tani pa pasur një çështje konkrete sepse pastaj do vështirësohej diskutimi. Unë e shikoj çështjen në funksion të zgjidhjes dhe të vendimmarrjes. Pra një rast mund të jetë rasti i votës dy të kryetarit me diskutimin që Avokati i Popullit tha që duhet të disponojë i pari kryetari më tej të disponojnë anëtarët e tjerë, por sido që të jetë vendimi juaj, procesi duhet të ketë mekanizmin zhblllokues të situatës.

Enkelejd Alibeaj kërkon fjalën dhe parashtron se ndonëse ka kaluar diskutimi, megjithatë i kthehem nenit 15. Nuk mund të merrni kompetenca të legjislativit dhe të përcaktoni çështje të kuorumit të cilat çojnë drejtpërdrejt tek çështja e konstituimit të KED. Kushtetuta ka përcaktuar që ky organ përbëhet nga 9 anëtarë dhe nuk përcakton kurrë, jo me

pak se 9 anëtarë. Për këtë arsye ka vendosur edhe mekanizmin e zëvendësuesve. Nuk është halli juaj, as problemi juaj nëse dështon një nga institucionet e tjera për të respektuar këtë imperativ kushtetues, siç ka dështuar deri tani Presidenti dhe Kuvendi. Nuk është drejta juaj në rregullore të përcaktoni konceptin e kuorumit. Së dyti, lidhur me nenin 16 ka një gjë tjetër e rëndësishme e që ka lidhje me pikën 3 të nenit 15, pikërisht me çështjen e pjesëmarrjes, detyrimi për pjesëmarrje. Nëse nuk merr pjesë në mbledhje merr spunto menjëherë procedimi disiplinor. Në rregullore duhet të trajtohen arsyet dhe momenti se kur do të duhet të bëhet prezent shkak për mospresëmarrje në mbledhje për të mos u ngarkuar me shkaqe procedimi disiplinor të pabaza, si edhe procedura kur nuk merr pjesë, kur duhet të komunikohet për të mos u bërë pengesë për zhvillimin e mbledhjes, të cilat duhet të deklarohen në procesverbal.

Lidhur me çështjen e shumicës ligji është i qartë kur përcakton masën e votave për të konkluduar në një vendimmarrje. Termi shumicë është term aritmetikore. Hipotezat nuk ekzistojnë asnjëherë sepse ka gjithmonë një prezumim. Në rastin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të kushteve, prezumimi është që të gjithë ata që aplikojnë dhe i plotësojnë, Këshilli mund të konfirmojë me shumicë. Barazia e votave do të thotë jo shumicë. Nuk është kushtetuese që kryetari mund të ketë qoftë edhe gjysmë vote më tepër. Ligji për funksionimin e organeve kolegjiale mund të rithirret vetëm për lëndë që ky ligj nuk i përcakton. Renditja e kandidatëve nuk është çështje vote, masën e plotësimit të kriterëve e vendos individualisht secili anëtar sipas rregullave standarde gjithmonë e më të detajuara për të ulur diskrecionin e vlerësimit.

Ulsi Manja kërkon fjalën dhe parashtron se nëse ndiqet kjo logjikë duhet të pranohet se vota nuk vlen dhe që verifikimi i kushteve dhe kriterëve ligjore nuk i nënshtrohet votës por standardeve që vendos Këshilli, pra ju mund të mos votoni për asnjë nga kandidatët as për në Gjykatën Kushtetuese, as për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Gjithsesi biem dakord që ligji për organet kolegjiale të aplikohet për ato raste kur nuk ka referim të qartë tek ligji organet e qeverisjes së drejtësisë. Në rastin hipotetik kur në mbledhjen e KED do të jenë 6 anëtarë dhe nuk ka zëvendësues sepse do të deklarojë konfliktin interesit etj.. dhe në mbledhje do të duhet shumica për të vendosur për një çështje, p.sh me rregulloren, si do të vendoset nëse ka barazi votash? Nëse vendosni rregullin që nuk miratohet atëherë çështja është e zgjidhur.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve dhe qëndrimeve të dakordësuara, e miratojnë me ndryshime dhe riformulime përmbajtjen e nenit 17 “Punimet e mbledhjes së Këshillit”. Në lidhje me pikën 12 dhe 13 të këtij neni, anëtarët e Këshillit *Ardian Dvorani*, *Arta Marku*, *Fatri Islamaj*, *Fatjona Memçaj* dhe *Eriol Roshi* votuan që pas anëtarit relator

për çështjen në shqyrtim voton Kryetari dhe në vijim anëtarët e tjerë, ndërsa kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare. Votuan kundër anëtarët **Vitore Tusha dhe Margarita Buhali**.

Anëtarët e Këshillit, kalojnë në shqyrtimin e përmbajtjes së nenit 18 “Procesverbali i mbledhjes”, i paraqitur me riformulime.

Diskutojnë anëtarët e Këshillit.

Erinda Ballanca, pas diskutimeve të zhvilluara mes anëtarëve, kërkon fjalën dhe parashtron se procesverbalin e përmbledhur do ta marrim dosmodoshmërisht sepse ai është publik. Të kemi të drejtë ta ballafaqojmë çfarë kemi thënë nëse kemi ndonjë kontestim për pjesën tonë dhe kjo mendoj që është një garanci normale sepse fjalët e mia që do bëhen publike nëse nuk janë në përputhje me procesverbalin do të çojnë në dezinformim të opinionit tërësisht. Kështu që është një e drejtë që duhet të jepet për përmbledhjen e fjalës sime. Nga ana tjetër ju gjykoni që nuk do të përmbledhim fjalën e anëtarëve duke bërë një interpretim të kësaj dispozite me dispozitën e shkeljeve disiplinore. Pra nuk duhet të jepet në asnjë rast qëndrimi i anëtarëve, ndërkohë që qëndrimi ka edhe arsyetim, aq me tepër që ligji thotë se vendimi duhet të jetë me arsyetim. Nëse në procesverbal që bëhet publik tregohet se AB votoi pro, BC votoi kundër dhe vetëm kaq, është një gjë shumë e thatë, sepse arsyetimi i vendimit nuk është në procesverbal. Mendoj që ndoshta procesverbali që do të bëhet publik duhet të ketë një lloj arsyetimi. Procesverbali i përmbledhur ka për qëllim që veprimet tona të mos jenë tërësisht mbyllura por të ketë dhe një transparence sepse atëherë nuk do kërkonte ligji që të bëhet publik. Kemi procesverbalin e përmbledhur, por kemi edhe komunikatën, të cilat përcaktohen në dy dispozita të ndryshme.

Ulsi Manja kërkon fjalën dhe parashtron se procesverbali i mbledhjes të këtij Këshilli që të marre fuqinë e një dokumenti, akti zyrtar, patjetër që do të duhet të miratohet në mbledhjen e radhës. Forma e komunikimit, pastaj paraprakisht mes anëtarëve të Këshillit se si do të njihen me procesverbalin p.sh në rrugë elektronike, ne kemi eksperiencë, kemi praktikë edhe në Kuvend. Dikur aplikojmë që procesverbali i zbardhur u vihej përpara fillimit të mbledhjes së radhës të gjithë anëtarëve të komisionit të ligjeve. Tani që ka hyrë edhe rruga e komunikimit elektronik, procesverbali i zbardhur nga audio u shkon gjithë anëtarëve të komisionit dhe kush ka vërejtje për procesverbalin, përpara se ta hedhin në votë dhe ta miratojmë shprehet nëse ai është zbardhur në mënyre korrekte dhe pas ballafaqimit me sistemin audio, nuk votohet më nga mbledhja, ballafaqohet me sistemin audio dhe pastaj në mbledhjen e radhës votohet. Lidhur me komunikimin me publikun është neni 226 që ia jep këtë kompetencë kryetarit, por thotë që se çfarë do të komunikohet me publikun, paraprakisht

do të duhet të konsultohet me anëtarët e KED. Këtë e ka detyrim edhe nga neni 233 që është Transparenca me publikun.

Por, ndërkohe, për anëtarët e KED, vlen edhe neni 242 për shkeljet disiplinore. Prandaj në përmbledhjen e procesverbalit që do ti njoftohet publikut, do të preferoja që edhe për fjalën time të ndiqet i njëjti standard. Të publikoni nga fjala ime në mënyre të përmbledhur po aq sa edhe fjalën e përmbledhur të secilit anëtar, që të mos duket kur të publikohet në faqen zyrtare sikur në mbledhjen e KED kanë mbajtur qëndrime vetëm të ftuarit, sikur mbledhjen nuk e zhvilloni ju por ne. Por gjithmonë anëtarët e Këshillit i kondicionin neni 242. Nëse do të dalin të plota në komunikimin me publikun sipas nenit 226 vetëm fjala jonë dhe pjesa tjetër do të jetë vetëm ora e mbledhjes, data e mbledhjes, pjesëmarrësit dhe cilat çështje diskutuan në rend dite, ky do të jetë një komunikim shume i thatë, do të duket sikur vetëm ne komunikojmë me publikun .

Erinda Ballanca, kërkon fjalën dhe parashtron se bëhet fjalë për regjistrim audio të gjithë mbledhjes, që është një mënyrë sesi mbahet të themi procesverbali, mund të jetë një mënyrë e mbajtjes së procesverbalit. Por kjo nuk mënjanon faktin që duhet të ketë një akt, një procesverbal i cili duhet të miratohet në mbledhje sipas rregullave të tjera të përgjithshme. Përtej kësaj dhe në fakt edhe ju duhet ta diskutoni, duhet të ketë 2 procesverbale, një procesverbal të plotë që do të jetë i dokumentuar, do të jetë në regjistrin e këshillit. Duhet të ketë dhe një procesverbal audio. Përveç kësaj, duhet të jetë procesverbali i përmbledhur sepse ky do të jetë një dokument publik që të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Komunikimi tjetër që ne kemi me publikun është nëpërmjet komunikatës që përcaktohet nga neni 233. Pra, do të publikohet procesverbali i përmbledhur dhe një komunikatë. Procesverbalin e përmbledhur e shikon një njeri që ka shumë interes të kuptoj më në detaje, pra nuk është i njëjti informacion qartësisht. Komunikata është një përmbledhje e mbledhjes me të cilën Këshilli komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat. Por procesverbali dhe komunikata nuk janë e njëjta gjë. Për komunikatën nuk ka nevojë për vendimmarrje të këshillit. Në procesverbalin e përmbledhur duhet të përfshihen ato fjalë, ato çështje për të cilat nuk kanë ndalim ligjor për ti përfshirë. Ndalimi ligjor që juve keni ka të bëjë me vlerësimin individual të kandidatëve apo për çështje që nxjerrin të dhëna personale të kandidatëve por jo me qëndrime parimore, të cilat juve nuk keni asnjë lloj. Megjithatë, ky është në vlerësimin tuaj. Për sa i përket përmbajtjes, nuk mund të ketë një procesverbal të përmbledhur ku tregohet vetëm se kush e mori fjalën.

Bledar Dervishaj, kërkon fjalën dhe parashtron se do të dëshiroja të evidentoja pak më praktikisht çështjen lidhur me procesverbalin, edhe referuar praktikës së KED-së. Edhe

sot ju keni dy punonjës, një që zbardh audion, që çdo dy orë kërkon pushim për shkak të teknikës dhe zonja që mban procesverbalin duke shkruajtur. Pra, mbajtësi i procesverbalit, ka formuar nga praktika e saj një metodologji, që e bën një përmbledhje, p.sh. mori fjalën përfaqësuesi i Presidentit të Republikës dhe tha. Referuar shpejtësisë së deklarimeve të çdo anëtari dhe të ftuari që merr fjalën, mbajtësja e procesverbalit nuk mundet fizikisht t'i shkruaj dot të gjitha cka deklarohen. Kështu që në këtë logjikë, edhe nga praktika e Kuvendit, unë bie dakord me çka komentoj deputeti i nderuar z.Manja, ku citoi se procesverbali audio duhet shoqëruar me patjetër me procesverbal të detajuar të plotë në format të shkuar e që do të duhet të shtrohet për diskutim dhe miratim në mbledhjen e radhës. Por nga ana tjetër ky Këshill ka dhe një detyrim, të komunikoj me publikun që t'i japë të kuptoj atij se kush foli, për aq sa lejohet për anëtarët dhe për ne të tjerët çfarë qëndrimi mbajtm.

Të përmbledhësh fjalën e një përfaqësuesi, p.sh., të Avokatit të Popullit, mendoj se mund të mos jetë dakord, mund të japë një konotacion të gabuar arsye prej së cilës marrin spunto dhe gazetatat/media pa fund. Kështu që shikojmë pak të vështirë, referuar dispozitës ligjore, përmbledhjen e diskutimit të të ftuarve apo pjesëmarrësve apo veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Ndoshta një ide mund të ishte që përmbledhja e procesverbalit mund të parashikonte atë që ju do të vendosnit dhe do të miratonit.

Ndërsa për ne, mund të thoni në ndonjë pjesë të dytë që mund të ishte edhe e tëra dhe kush do ta lexojë, le ta lexojë, pra për të mos ndikuar me njëra – tjetrën, këto dy akte në tërësi si dokumente. Por, në qoftë se unë nuk do të ndihesha mirë me fjalën e përmbledhur, çdo të bëja?!, Do të vija tek kryetari, t'i kërkoja ballafaqim, do të dëgjoja audion sepse ndërkohë që, efektin përmbledhja e fjalës ndërkohë e ka dhënë dhe mund ta ketë dhënë në mënyrë të gabuar. Unë mendoj që pjesa jonë mos të ishte në atë, vetëm po të ishte *attached*.

Genci Gjonçaj, kërkon fjalën dhe parashtron se që në mbledhjen e parë ka qenë debat se deri ku shkon hapësira jonë për të komunikuar me Këshillin. Në vështrimin tim të ligjit ne e kemi vetëm thjesht një pozicion vëzhgues. Avokati i Popullit e ka pozicionin vëzhgues pak më specifik. Ka një sfidë lidhur me dokumentimin e veprimtarisë së Këshillit. Është e thjeshtë, procesverbali transkriptohet siç dëgjohet audio, transkriptohet në hard copy më vete. Unë nuk di nëse është e mundur afati i shkurtër për zbardhje. Eksperienca jonë në Kuvend, ku kemi 18 redaktorë, tregon se edhe aty ka vështirësi. Sfidat e dytë është të komunikosh me publikun. Dhe është Këshilli që komunikon, jo përfaqësuesi i Presidentit apo i Kryetarit të Kuvendit. Padyshim, me ndalesat përkatëse që ka parashikuar ligji Këshilli duhet të paraqesë materialin për publikun. Për sa i takon fjalëve të përfaqësuesit të Kryetarit të Kuvendit, çfarë do që të them unë, përsëri mbledhja është në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Unë nuk jam

anëtar i këtij Këshilli. Ajo që bën interes për publikun nuk është çfarë tha përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit, ndoshta edhe përfaqësuesi i Presidencës, nuk po hyj tek pjesa politike. Ajo që i intereson publikut është çfarë tha, bisedoi dhe çfarë vendosi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Pa dyshim që Avokati i Popullit ka një pozicion më specifik dhe pa dyshim duhet të trajtuar më me kujdes, por interesi në këtë rast është për mbledhjen e Këshillit.

Enkelejd Alibeaj kërkon fjalën dhe parashtron se çështja është parimore dhe duhet konsideruar si e tillë. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ligji i përcakton të mbyllura por sekrete. Së dyti, nuk ka asnjë zgjidhje tjetër nëse duhet të zbardhet ose jo materiali audio sepse është detyrim ligjor, pjesë e procedurës administrative të dokumentimit të veprimtarisë administrative. Detyrimi pas kësaj është që, çdo pjesëmarrës në mbledhje, ta konsultojnë fjalën e vetë paraprakisht dhe të bëj edhe eventualisht ndonjë ndryshim që i duket sikur nuk pasqyron besnikërisht fjalën. Lidhur me pjesën tjetër delikate që a duhet bërë publike dhe sa duhet bërë publike. Nuk ka mbrojtje më të mirë për ju sesa të bëni transparencë të plotë. Çështja do të jetë e përmbledhur apo jo, që diskutimet e anëtarëve të mos bëhen fare publike apo të atyre që janë të ftuar të bëhen në mënyrë përmbledhtazi, në fakt, në thelbin e vetë ka problemin e përballjes me publikun. Ky organ për faktin që është kushtetues dhe për lëndën që trajton do të ketë sy që e monitorojnë. Për mos ti lënë hapësirë manipulimit mediatic apo politik, mjete i vetëm është të bëhet transparencë të plotë. Kështu nuk do të merrni kosto të pa merituar. Sepse që do të bëhen publike ato se çfarë janë diskutuar këtu kurrë nuk do ti shpëtoni kësaj gjëje. Nëse nuk ka kapacitete ato të shtohen nga administrata e Gjykatës së Lartë që veç punëve të tjera të jenë edhe në shërbimin e Këshillit, në kohë dhe më cilësi. Nesër, pasnesër do të dalin procesverbalet, siç dalin dhe dokumente të tjerë dhe mund të merren edhe me keqinterpretimin e gjësë, do të përgojoheni në gjysmën e mediave dhe gjysmën e sferës politike. Do të jeni në pozicion të pambrojtshëm. Për fjalën time këtu, do të doja të jepej pikë për pikë çdo rast sepse këtu nuk vijmë me një titull personal.

Anita Mihailova (përkthen përkthyesja), kërkon fjalën dhe parashtron se në cilësinë e ekspertit të EURALIUS që punon me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi kemi mendimin që, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të zbardhë dhe votojë përmbajtjen e plotë të procesverbalit duke u bazuar në regjistrimet audio. Ky dokument ka një natyrë të brendshme. Dy dokumentet e tjera të cilat duhet të hartohen nga Këshilli dhe këto kanë një karakter publik, njëri prej tyre është përmbledhja e procesverbalit dhe tjetri është komunikata për shtyp. Këto dy dokumente duhet të botohen, të bëhen publike në përputhje me ligjin. Neni 232 pika 3, i referohet procesverbalit të përmbledhur, ndërsa neni 233 i referohet

komunikatës për shtyp. Ajo çfarë ju duhet të bëni në këtë takim duhet të vendosni sesi këto dy dispozita pasqyrohen në rregulloren tuaj dhe ajo çka unë e shikoj që nuk është rregulluar mjaftueshëm në mënyrë të mirë në këto dispozita është procesverbali i përmbledhur.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve dhe qëndrimeve të dakordësuara, e miratojnë me ndryshime dhe riformulime përmbajtjen e nenit 18 “Procesverbali i mbledhjes”.

Në lidhje me çështjet e debatuarra për përmbajtjen e këtij neni, *anëtarët e Këshillit unanimisht votuan që procesverbali i përmbledhur miratohet në mbledhjen pasardhëse të Këshillit, të përmbajë qëndrimet dhe votimin e anëtarëve, por diskutimet e anëtarëve të mos përfshihen në procesverbalin e përmbledhur.*

Anëtarët Vitore Tusha, Arta Marku, Fatri Islamaj dhe Fatjona Memçaj votuan që një përmbledhje e diskutimit të Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të ftuara të paraqitet në procesverbalin përmbledhës që bëhet publik, si edhe që tu jepet paraprakisht për verifikim të fjalës së tyre, përpara miratimit në mbledhje. *Votuan kundër anëtarët Ardian Dvorani, Margarita Buhali dhe Eriol Roshi.*

Ardian Dvorani, pas këshillimit me pjesëmarrësit cakton 10 minuta pushim.

PJESA E TRETË E MBLEDHJES

Ardian Dvorani, orienton vijimin e diskutimit të dispozitave të projektregullores me nenin 18 “Komunikimi me publikun”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Pas diskutimit dhe sugjerimeve konkrete të anëtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje për përmbajtjen e dispozitës, anëtarët e Këshillit e miratojnë me disa shtesa dhe ndryshime nenin 18 të projektregullores.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 19 të projektregullores “Kompetencat e kryetarit”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Pas diskutimit dhe sugjerimeve konkrete të anëtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje për përmbajtjen e dispozitës, anëtarët e Këshillit e miratojnë me disa shtesa dhe ndryshime nenin 19 të projektregullores.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 20 “Personeli administrativ dhe detyrat e tij”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 21 “Stafi ndihmës i relatorit”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 22 “Regjistrat, dokumentacioni dhe administrimi i çështjeve”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 23 “Dispozitë kalimtare”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe miratojnë përmbajtjen e dispozitës së nenit 24 “Hyrja në fuqi”, sipas riformulimeve të paraqitura në mbledhje.

Në përfundim të diskutimeve, shqyrtimit dhe miratimit nen për nen, *anëtarët e Këshillit votuan unanimisht për miratimin në tërësi të Rregullores së Brendshme për Funksonimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.*

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani duke shpallur zhvillimin e mbledhjes së radhës në datën 15.02.2019, ora 10.00 me rend dite diskutimi dhe miratimi i projektvendimit nomativ për shortin, si edhe diskutim në parim për procedurat e verifikimit të kandidatëve, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 18.15

Sekretare

Kryetari

Redjona Myrtja

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal.
Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.